



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2019:151573

Datë: 29.08.2024

Numri i dokumentit: 06099608

PKR.nr.351/2007

- **GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-Departamenti për Krime të Rënda**, Kryetari i trupit gjykues Fatos Sejdiqaj, me bashkëpunëtoren profesionale Donjeta Tahiri, në çështjen penale ndaj të pandehurit F.P. nga Mitrovica, për shkak të veprave penale-Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike nga neni 229 par.1 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës UNMIK/RREG/2003/25 (tutje:KPPK) dhe Prodhimi dhe përpunimi i paautorizuar i narkotikëve të rrezikshëm dhe i substancave psikotropike nga neni 230 par.1 të KPPK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së ish-Prokurorisë Publike të Qarkut në Mitrovicë, tani Prokuroria Themelore në Mitrovicë PP.nr.128/2005, të datës 26.12.2007, plotësuar me parashtresën me shkrim të datës 13.02.2024, sipas detyrës zyrtare me datën 29.08.2024, mori këtë :

A K T V E N D I M

I.- HEDHET aktakuza e ish-Prokurorisë Publike të Qarkut, tani Prokuroria Themelore në Mitrovicë PP.nr.128/05, e datës 26.12.2007, dhe **Pushohet** procedura penale ndaj të pandehurit :

F.P., nga i ati, e ëma, e vajzërisë, lindur më datë, në Mitrovicë, tani me vendbanim në rrugën “.....” nr..... Mitrovicë, me numër personal, serb, Shtetas i Republikës së Kosovës :

- Për veprën penale-Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike nga neni 229 par.1 të KPPK-së dhe veprën penale-Prodhimi dhe përpunimi i paautorizuar i narkotikëve të rrezikshëm dhe i substancave psikotropike nga neni 230 par.1 të KPPK-së, **për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale.**

II.- Në mbështetje të neneve 229 par.5, 230 par.5 të KPPK-së dhe nenit 276 par.1 të KPP-së, **URDHËROHET** konfiskimi i përhershëm i substancës narkotike dhe atë : 0.25 gramë drogë e llojit

“Heroinë”, tre (3) kutia me fara të llojit “Marihuanë”, njëzetë (20) tableta “Trodon”, dymbëdhjetë (12) tableta “Maprotil”, tridhjetë (30) tableta “Klealon” dhe pesëdhjetë (50) tableta “Largatil”. Pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi, këta narkotikë duhet të shkatërrohen nga Policia e Kosovës, sipas procedurave ligjore në fuqi.

III.- Shpenzimet e procedurës penale, mbulohen nga mjetet buxhetore të kësaj Gjykate.

IV.- Palë të dëmtuar sipas aktakuzës nuk kishte.

A r s y e t i m

- Ish-Prokuroria Publike e Qarkut në Mitrovicë, tani Prokuroria Themelore në Mitrovicë ka ngritur aktakuzën PP.nr.128/05, të datës 26.12.2007, plotësuar-korrigjuar me parashtrësën me shkrim të datës 13.02.2024, ndaj të pandehurit F.P. nga Mitrovica, për shkak të veprave penale-Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike nga neni 229 par.1 të KPPK-së dhe Prodhimi dhe përpunimi i paautorizuar i narkotikëve të rrezikshëm dhe i substancave psikotropike nga neni 230 par.1 të KPPK-së.

- Këtë lëndë penale Kryetari i Trupit Gjykses e ka pranuar me datën 19.01.2024 dhe pasi që ka pranuar të njëjtën, ka konstatuar se ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale sa i përket veprës penale-Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike nga neni 229 par.1 të KPPK-së, po ashtu ka konstatuar se ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale sa i përket dhe veprës penale-Prodhimi dhe përpunimi i paautorizuar i narkotikëve të rrezikshëm dhe i substancave psikotropike nga neni 230 par.1 të KPPK-së, ndaj këtij të pandehuri.

- Gjetjet e Gjykatës për pikën –I- të dispozitivit të aktakuzës -

- Nga shkresat e lëndës rrjedh se i pandehuri veprën penale-Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike nga neni 229 par.1 të KPPK-së, e ka kryer me datë 19.02.2004, dhe që nga ajo kohë e deri më tani kanë kaluar më shumë se nëntëmbëdhjetë (19) vite.

- Sipas nenit 90 paragrafi 1, nënparagrafi 4 të KPPK-së përcaktohet se, ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse kanë kaluar: *“Pesë vjet nga kryerja e veprës së dënueshme me më shumë se tre vjet burgim”*. Ndërsa sipas nenit 91, par.6 të KPPK-së, përcaktohet se *“ndjekja penale ndalohet në cdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit (ndalesa absolute mbi ndjekjen penale)”*.

- Në rastin konkret i pandehuri veprën penale-Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike nga neni 229 par.1 të KPPK-së, për të cilën është përcaktuar **dënim me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet**, dyshohet se e ka kryer **me datë 19.02.2004**, e që nga kjo kohë e deri më tani kanë kaluar më shumë se nëntëmbëdhjetë (19) vjet, që do të thotë se ka kaluar dyfishi i afatit që kërkohet për arritjen e parashkrimit, çka ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale në bazë të nenit 90 par.1, nënpar.4, dhe 91 par.6 të KPPK-së.

- Gjetjet e Gjykatës për pikën –II- të dispozitivit të aktakuzës –

- Lidhur me veprën penale si në pikën-II- të dispozitivit të aktakuzës-Prodhimi dhe përpunimi i paautorizuar i narkotikëve të rrezikshëm dhe i substancave psikotropike nga neni 230 par.1 të KPPK-së, tani edhe për këtë veprë penale Gjykata ka konstatuar se ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale.

- Sipas nenit 90 paragrafi 1, nënparagrafi 3 të KPPK-së përcaktohet se, ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse kanë kaluar: *“dhejtë (10) vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se pesë (5) vjet burgim”*. Ndërsa sipas nenit 91, par.6 të KPPK-së, përcaktohet se *“ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit (ndalesa absolute mbi ndjekjen penale)”*.

- Sipas përshkrimit faktik të veprës penale si në pikën –II- të dispozitivit të aktakuzës dhe shkresave të lëndës, në rastin konkret i pandehuri veprën penale-Prodhimi dhe përpunimi i paautorizuar i narkotikëve të rrezikshëm dhe i substancave psikotropike nga neni 230 par.1 të KPPK-së, për të cilën është përcaktuar **dënim me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet**, dyshohet se e ka kryer **me datë 13.04.2004**, ndërsa që nga kjo kohë e deri më tani kanë kaluar më shumë se njëzetë (20) vite, që do të thotë se ka kaluar dyfishi i afatit që kërkohet për arritjen e parashkrimit, që nënkupton se me datë 13.04.2024 ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale në bazë të nenit 90 par.1, nënpar.3, dhe nenit 91 par.6 të KPPK-së.

- Megjithatë, në rastin konkret vlenë të theksohet fakti se, **para pranimit të kësaj lënde penale me datë 19.01.2024 nga Kryetari i trupit gjykues**, Gjykata ka gjetur se për këtë veprë penale-Prodhimi dhe përpunimi i paautorizuar i narkotikëve të rrezikshëm dhe i substancave psikotropike nga neni 230 par.1 të KPPK-së, **kishte arritur parashkrimi relativ i ndjekjes penale me datë 15.02.2018**, për arsyet dhe rrethanat si në vijim :

- Në nenin 90, paragrafi 1, nën-paragrafi 3 të KPPK-së, përcaktohet se ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse kanë kaluar: “*dhjetë (10) vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se pesë (5) vjet burgim*”. Ndërkaq, sipas nenit 91, par.1 të KPPK-së, “*afati i parashkrimit të ndjekjes penale fillon të rrjedh nga dita kur është kryer vepra penale*”, paragrafi 3 përcakton: “*Afati i parashkrimit ndërpritet me çdo veprim i cili ndërmerret për qëllime të ndjekjes penale të veprës penale të kryer*”, ndërsa paragrafi 4 parasheh: “*Afati i parashkrimit ndërpritet po ashtu kur kryerësi kryen një veprë tjetër penale me peshë të barabartë ose më të rëndë se sa vepra penale para skadimit të afatit të parashkrimit*”.

- Gjykata, nga shkresat dhe provat që gjenden në këtë lëndë penale si dhe nga rrethanat e këtij rasti, ka gjetur se nuk ishte paraqitur asnjë nga rrethanat që do të ndalonte rrjedhën e parashkrimit të ndjekjes penale, në afatin dhjetë (10) vjeçar, afat ky i paraparë për parashkrim relativ për veprën penale Prodhimi dhe përpunimi i paautorizuar i narkotikëve të rrezikshëm dhe i substancave psikotropike nga neni 230 par.1 të KPPK-së, për të cilën akuzohet i pandehuri F.P. si në pikën II të aktakuzës.

- Gjykata rithekson se, në rastin konkret i pandehuri është akuzuar për këtë veprë, për të cilën veprë penale parashihet **dënimi me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet, të cilën dyshohet ta ketë kryer me datën 13.04.2004**, ndërsa veprimi i fundit i ndërmarrë në drejtim të ndjekjes penale sipas shkresave të lëndës, Gjykata ka vlerësuar se është data 15.02.2008, datë kjo e cila sipas fletëkthesave të Gjykatës, konstatohet se palët subjekte në procedurë janë njoftuar-kanë pranuar Aktvendimin nga ish-Gjykata e Qarkut në Mitrovicë KP.nr.21/2008 i datës 11.02.2008, me të cilën është vërtetuar aktvendimi për konfirmimin e aktakuzës, dhe nga kjo datë, pra data 15.02.2008 e deri më tani, nuk ishte ndërmarr asnjë veprim në drejtim të ndjekjes penale.

- Rrjedhimisht, Gjykata gjenë se nga data 15.02.2008, datë kur është pranuar Aktvendimi KP.nr.21/2008, e deri më tani para pranimit të kësaj lënde penale nga Kryetari i trupit gjykues kanë kaluar më shumë se dhjetë (10) vjet, dhe nga kjo datë e deri **me datën 15.02.2018** nuk është ndërmarrë asnjë veprim me qëllim të ndjekjes penale, që do të ndërpriste rrjedhën e afatit të parashkrimit relativ, çka do të thotë se ka arritur parashkrimi relativ i ndjekjes penale në bazë të nenit 90, par.1, nënpar.3 të KPPK-së. Saktësisht, parashkrimi relativ i ndjekjes penale në këtë rast penal kishte arritur me datë 15.02.2018, ditë kjo kur janë mbushur dhjetë (10) vjet nga dita kur është ndërmarr veprimi i fundit në drejtim të ndjekjes penale, ngase brenda kësaj periudhe kohore nuk është ndërprerë rrjedha e afatit të parashkrimit dhe nuk ka përfunduar ndjekja penale.

- Bazuar në verifikimet e realizuara në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, përmes Zyrës për Menagjimin e Lëndëve përkatësisht, nga Sistemi Qendror i Evidencës Penale të Kosovës (SQEPK), njoftuar me parashtrësën me shkrim P.nr.351/2007 të datës 29.01.2024, vërtetohet se ndaj të pandehurit F.P. përveç kësaj lënde, janë zhvilluar edhe procedura tjera, respektivisht rezulton i dënuar me aktgjykime të formës së prerë në këto raste :

- a. Lënda sipas Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë P.nr.112/2007, i plotëfuqishëm nga data 26.10.2007, për veprën penale-Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike nga neni 229 par.2 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës UNMIK/RREG/2003/25, për të cilën është paraparë dënim me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.
- b. Lënda sipas Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, P.nr.536/2006, i plotëfuqishëm nga data 06.03.2007, për veprën penale-Kanosja nga neni 161 par.1 lidhur me par.3 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës UNMIK/RREG/2003/25, për të cilën është paraparë dënim me gjobë apo me burgim deri në gjashtë (6) muaj.
- c. Lënda sipas Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, P.nr.596/2018, i plotëfuqishëm nga data 03.12.2021, për veprën penale-Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.1 të Kodit Penal Nr.04/L-082, për të cilën është paraparë dënim me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tre (3) vjet.

Megjithatë, pavarësisht se i pandehuri F.P. ishte i dënuar me aktgjykim të formës së prerë në këto raste, Gjykata vlerëson se të njëjtat nuk e kanë ndërprerë rrjedhën e afatit të parashkrimit. Bazuar në nenin 91, par. 4 të KPPK-së, rrjedh se afati i parashkrimit ndërpritet kur kryerësi kryen një vepër tjetër penale **me peshë të barabartë ose më të rëndë se sa vepra penale para skadimit të afatit të parashkrimit**. Referuar aktgjykimeve me të cilat është dënuar i pandehuri, e të cekura më lartë, të gjitha veprat për të cilat është dënuar **nuk janë me peshë të barabartë e as më të rëndë me veprën penale sipas kësaj aktakuze**. Të gjitha këto vepra për të cilat i pandehuri është dënuar kanë dënueshmëri më të ultë, që nënkupton se këto vepra penale nuk e kanë ndalur rrjedhën e afatit të parashkrimit relativ sa i përket veprës penale sipas pikës –II- të dispozitivit të aktakuzës.

- Si përfundim, Gjykata konstaton se parashkrimi absolut i ndjekjes penale, është një fakt dhe rrethanë që në çdo rast sapo të vërtetohet se ekziston, Gjykata obligohet sipas ligjit ta hedh aktakuzën dhe pushoj procedurën penale ashtu që, pamundëson ligjërisht që Gjykata të ndërmerrë ndonjë veprim në drejtim të ndjekjes penale e për pasojë është rrethanë që pengon ndjekjen penale, prandaj vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi që të hedh aktakuzën e ish-Prokurorisë Publike të Qarkut në

Mitrovicë, tani Prokuroria Themelore në Mitrovicë PP.nr.128/05, të datës 26.12.2007 dhe të pushojë procedurën penale ndaj të pandehurit F.P., për veprën penale-Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike nga neni 229 par.1 të KPPK-së, dhe veprës penale-Prodhimi dhe përpunimi i paautorizuar i narkotikëve të rrezikshëm dhe i substancave psikotropike nga neni 230 par.1 të KPPK-së, për shkak të arritjes së afatit të parashkrimit absolut të ndjekjes penale, konform nenit 90 par.1, nënpar.3 dhe nënpar.4 si dhe nenit 91 par.6 të KPPK-së, lidhur me nenin 357 par.1, nënpar.1.3 të Kodit Nr.08/L-032 të Procedurës Penale (KPP).

- Gjykata duke u bazuar në dispozitën ligjore të neneve 229 par.5 dhe 230 par.5, lidhur me nenin 276 par.1 të KPP-së, vendosi si në pikën -II- të dispozitivit të këtij aktvendimi ashtu që, Urdhëroi konfiskimin e përhershëm të substancës narkotike : 0.25 gramë drogë të llojit “Heroinë”, tre (3) kutia me fara të llojit “Marihuanë”, njëzetë (20) tableta “Trodon”, dymbëdhjetë (12) tableta “Maprotil”, tridhjetë (30) tableta “Klealon” dhe pesëdhjetë (50) tableta “Largatil”, të cilat pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi, duhet të shkatërrohen nga Policia e Kosovës sipas procedurave ligjore në fuqi.

- Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale mbështetet në nenin 453 par. 1 të KPP-së.

- Nga arsyet e lartcekura e në kuptim të nenit 90, par.1 nënpar.3, nënpar.4 dhe 91 par.6 të KPPK-së e lidhur me nenin 357 par. 1, nën par.1.3 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti për Krime të Rënda

PKR.nr.351/2007, me datë 29.08.2024.

Kryetari i Trupit Gjykses,

Fatos Sejdijaj

- **KËSHILLË JURIDIKE** : Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa e personave të autorizuar në afatin prej tre (3) ditësh nga pranimi i tij, nëpërmes kësaj Gjykate për Gjykatën e Apelit.